

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR Albania Human Capital

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Forma e shoqerise

Shoqeria ka formen e nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e cila themelohet nga Ervin Kepi dhe Elvis Inçi, ku ortaket e meposhtem perballojne humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne Kapitalin Themeltar.

Veprimitaria e shoqerise do te regullohet nga ky statut, nga dispozitat perkatese te Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare", Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" si dhe nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Shoqeria e fiton personalitetin jurdik qe nga dita e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB), ne regjistrin tregetar.

Neni 2

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot me date 29/07/2021, ne, themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar me emrin "Albania Human Capital".

Themeluesi i shoqerise eshte *Edvin Kepi, shtetas shqipetar, lindur ne Tirane me 16/02/1978 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plete juridike e per te vepruar, identifikuar me Karte Identiteti Nr.036026864*

Dhe

Elvis Himçi, shtetas shqipetar, lindur ne Vlore me 18/08/1986 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plete juridike e per te vepruar, identifikuar me Karte Identiteti Nr.036431594

Neni 3 Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

1. Rekrutimin e punonjësve të huaj në RSH;

2. Punësimi i punonjësve në pozicione të ndryshme pune sipas aftësisë dhe preferencave të tyre.
3. Agjenci Turistike, organizim udhëtimesh individuale ose në grupe për shtetas shqiptar dhe të huaj brenda dhe jashtë vendit, promovimi i turzimit në Shqipëri dhe jashtë saj, shitje biletash, transport turistik tokesor.

Neni 4
Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jetë me afat te pacaktuar dhe fillon me regjistrimin e shoqerise ne Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqerise mund te vodosin kufizimin e afatit te veprimtarise dhe me pas zgjatjen e saj nje apo disa here sipas një vendimi te posacem.

Neni 5
Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne Rr. "Medar Shtylla" Nr. 40, Njesia Nr.5, Tirane

Kreu II
Kapitali

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 Lekë, i ndarë në 2 kuota.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar tërësisht nga ortakët e shoqerise perkatesisht:

Edvin Kepi, zoterues i 1 kuote, që perfaqesojne 50 % të kapitalit themeltar të shoqerisë, me vlore te per gjithshme 50 lekë.

Elvis Himçi, zoterues i 1 kuote, që perfaqesojne 50 % të kapitalit themeltar të shoqerisë, me vlore te per gjithshme 50 lekë.

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet pa kufi ne cdo moment, nje ose disa here, me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angzhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Ortaket, mund te zmadhojne kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Ortakeve.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 8 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te shoqerise me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashegimise;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve dhe te treteve, per sa kohe nuk parashikohet ndryshe ne statut. Kjo mund te behet me nje kontrate dhurimi.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

Kreu III Organet Vendimmarrese dhe Drejtuese

Neni 9 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise dhe qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshjet e me poshtme:

- a. percaktimin e politikave tregetare te shoqerise;
- b. ndryshimet ne statut;
- c. emerimin apo shkarkimin e administratoreve;
- d. emerimin apo shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne pikat c dhe d te kesaj pike;
- f. mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h. zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit;
- i. pjestimin e kuotave apo anulimin tyre;
- j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykatet dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorve;
- k. riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l. miratimin e rregullave procedurale dhe mbledhjeve te asamblese;
- m. ceshjet e tjera te parashikuara nga ligji apo statut.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarta me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Neni 10 **Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e per gjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga Ligji "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", nga ligje te tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se per gjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike, e cila duhet te permbaje daten, oren, vandin dhe rendin e dites, e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuari per mbledhjen e Asamblese.

Asambleja e Pergjitheshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

Asambleja e Pergjitheshme thirret kur shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj , propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vleren me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Asambleja e per gjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlore me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Neni 11 **Administrimi**

Asambleja e Pergjitheshme emeron një ose me shumë persona fizike si administratore te shoqerise per një periudhe kohe 5 vjet me të drejtë riperteritje.

Administrator i shoqerise Albania Human Capital do të jetë ortaku themelues, Z. Edvin Kepi.

Neni 12
Kompetencat e Administratorit

Administratorret kane të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmirësuar Qendren Kombëtar të Regjistrimit;
- e) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmirësuarë e shoqërisë tregtare;

Neni 13
Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon ne rast se:

1. personi nuk eshte më Administrator sipas parashikimeve te Ligjit perfshire edhe parashikimet e pikes 6 të nenit 95 të Ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”;
2. personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese;
3. personi vuani ose mund te vuaje nga çrrëgullime mendore;
4. personi jep doreheqjen nga detyra duke njofuar shoqerine.

Kreu IV

Neni 14
Viti Financiar

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor, perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e rregjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 15
Fitimi

Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor u shperndahen ortakeve ne proporcione me vleren nominale te kuotes se kapitalit themeltar te zoteruar.

Neni 16
Eksperti Kontabel

Shoqeria fillimisht do te kete nje ekspert kontabel, i cili do te emerohet nga Asambleja Pergjishme per nje periudhe e cila do te percaktohet ne kontraten e punesimit.

Eksperti kontabel do te jete perqegjes per te gjitha aktet dhe bilacet kundrejt Asamblese Pergjithshme, kundrejt ligjit shqiptar dhe nderkombetar me rendesite qe kjo perfshin.

Kreu V

Neni 17
Prishja

Shperndarja ose prishja e shoquerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendin te Asamblese se Pergjithshme;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) nese nuk ka kryer veprimitari tregetare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise;
- e) Me vendim gjykate.

Neni 18
Likuidimi

Prishja e shoquerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur procedura e falimentimit.

Per te administruar kete procedure Asambleja emeron nje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe te pasivit te shoquerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.

Pas pagimit te kreditorve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do t'i shprerndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne propocione me vleren nominale te kuotes se zoteruar prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 19
Riorganizimi i shoquerise

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Ne rastet kur aktiviteti mbylljet, per shkak riorganizimi, afatet e mbylljes vendosen nga Asambleja e Pergjitheshme.

**Neni 20
Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Ky statut do të interpretohet bazuar në qëllimin e vërtetë dhe të përbashkët të palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërsi.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Kodi Civil, dhe cdo ligj tjeter ne Republiken e Shqiperise qe rregullon kete marredhenie juridike.

**Neni 21
Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis shoqerise dhe te treteve, do te jete kopetente Gjykata Shqiptare.

Akti i Themelimit hartohet ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe, dhe pasi u lexua nga ortaket u nenshkrua pa verejtje para mua Noterit dhe une e noterizova.

**ORTAKËT THEMELUES
TË SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
Albania Human Capital

Z. Edvin Kepi

Z. Elvis Himçi

